

**MARREVESHJE**  
**PER : NDARJEN E SHOQERISE**  
**"Dimex" Shpk**

Dures me 3.05.2021

**Shoqeria "Dimex" Shpk** eshte regjistruar si person juridik me vendimin e Gjykates Rrethit 2430, dt. 09.03.1994, me seli Lagja 14, Shkozet Dures

Shoqeria **"Dimex" Shpk** me NIPT-in J618055190 , me Administrator z. Dhimiter Roko, aktualisht ka nje Kapital prej 19.265.280 leke, me ortake: Zotali Çobanaj me 1 (nje) kuote, 50% te kapitalit me kontribut 9.632.640 leke dhe Dhimiter Roko me 1 (nje) kuote, 50% te kapitalit me kontribut 9.632.640 leke.

Pas bisedimesh paraprake eshte rene dakort per ndarjen e kesaj shoqerie, ne zbatim te ligjit 9901 date 14.04.2008 per "Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" te nenit 215 pika 1 ne dy shoqeri pritese dhe konkretisht:

**Ne Shoqerine pritese "Solid ONE Group" shpk**

**Ne Shoqerine pritese "TACI DETERGENT GROUP" shpk**

Ne zbatim te nenit 216 pika 1 te ligjit 9901 date 14.04.2008 per "Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" hartohet ky projek per ndarjen e shoqerise me keto kushte :

1. **Ndarja** do te kryhet ne formen e shkeputjes ku shoqeria "Dimex" shpk do te jete mema (ndaresja) ndersa shoqerite "Solid ONE Group" shpk dhe "TACI DETERGENT GROUP" shpk do te jene shoqeri pritese ( bija, te ndara). Shoqeria "Dimex" shpk qe ndahet vleresohet e prishur, ne zbatim te nenit 227 pika 1 te ligjit 9901 date 14.04.2008 per "Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare".
2. **Raporti kembimit** te kuotave do te jete ne zbatim te ligjit 129/2014 date 02.10.2014 ne ndryshim te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" nenit 68 pika 2, ku çdo ortak ka nga 1(nje) kuote, dhe mbi bazen e vleres se kuotes te sejcilit ortak qe ka para ndarjes, kalon edhe ne shoqerite e reja qe krijohen nga ndarja (si numer dhe vlere kuote ne shoqerite me pergjegjesi te kufizuar).
3. **Kushtet e ndarjes** te kuotave te shoqerise pas ndarjes do te jene ne zbatim te ligjit 129/2014 date 02.10.2014 ne ndryshim te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" nenit 68 pika 2, ku çdo ortak ka nga 1(nje) kuote, ndersa pjesemarrja ne kapitalin themeltar te shoqerive te reja qe krijohen nga ndarja,do jete mbi bazen e raportit qe ze vlere e sejciles kuote ne kapitalin themeltar ndaj totalit te kapitalit themeltar te shoqerive te reja me pergjegjesi te kufizuar.
4. **Data**, duke u nisur nga e cila zotëruesit e kuotave (ortaket e shoqerive pas ndarjes) kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e fitimit qe do te jete 01.01.2021.
5. **Data**, duke nisur nga e cila veprimet e shoqërisë pritese "Solid ONE Group" shpk dhe shoqeria pritese "TACI DETERGENT GROUP" shpk që dalin nga ndarja do të trajtohen nga pikëpamja kontabël si veprime të shoqërisë ndarese "Dimex" shpk do te jete 01.01.2021.
6. **Të drejtat** që shoqëria pritese "Solid ONE Group" shpk u njeh zotëruesve të kuotave (ortakeve), jane ato qe percaktohen ne statutin e shoqerise, **Të drejtat** që shoqëria pritese

  
Dimex SH.P.K.  
Lagja nr 14, Rrethi i Shkozës, Dures  
Kategoria Industriale, Shkozet, Dures  
T.E. 0046/2008  
Dimex nr 0046/2008

- “TACI DETERGENT GROUP” shpk u njeh zotëruesve të kuotave (ortakeve), jane ato qe percaktohen ne statutin e shoqerise, te drejta keto ne zbatim te ligjit 9901 date 14.04.2008 per “Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare”.
7. **Perparesite** apo kufizimet e Administratoreve te shoqerive se reja pas ndarjes do te jene ato qe i njeh statuti i sejciles shoqeri ne zbatim te ligjit 9901 date 14.04.2008 per “Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare”.
  8. **Pasojat** e ndarjes nuk do te kene asnje influence ndaj te punesuarve te shoqerise qe merr pjese ne procesin e ndarjes.
  9. **Pasojat** e ndarjes nuk do te kene asnje influence ndaj te treteve te shoqerise para ndarjes.
  10. **Ortak i Vetem** i shoqerise pritesë “Solid ONE Group” shpk do te jete Zotali Çobanaj dhe Ortak i Vetem i shoqerise pritesë “TACI DETERGENT GROUP” shpk do te jete Dhimiter Roko.
  11. **Emrat e shoqerive** se krijuar nga ndarja do te jene: shoqeria pritesë “Solid ONE Group” shpk dhe shoqeria pritesë “TACI DETERGENT GROUP” shpk.
  12. **Selite e shoqerive** se reja pritesë do jene:
    - a) Per shoqerine pritesë “Solid ONE Group” shpk Lagja 14 Shkozet, Rruga “Vesa”, Zona Kadastrale 8516 Pasuria 6/60-Nd, Durres.
    - b) Per shoqerine pritesë “TACI DETERGENT GROUP” shpk Lagja 14 Shkozet, Rruga “Vesa”, Zona Kadastrale 8516 Pasuria\_6/365/Nd+3, Durres.
  13. **Statuti i shoqerive** se reja pas ndarjes do te jete i veçante per sejcilen shoqeri.
  14. **Objekti veprimtarise i shoqerive** se reja pas ndarjes do te jete i veçante per sejcilen shoqeri qe do te percaktohet ne statutin e sejciles.
  15. **Administratori i shoqerise** pritesë “Solid ONE Group” shpk do te jete Zotali Çobanaj me nje mandat 5 vjeçar dhe Administratori i shoqerise pritesë “TACI DETERGENT GROUP” shpk do te jete Dhimiter Roko me nje mandat 5 vjeçar.
  16. **Baza e nisjes** per ndarjen do te jene treguesit e bilancit te dates 31.12.2020, ndersa aktiviteti i vitit 2021 do te jete i perbashket me sistemimet e nevojeshme sipas Standarteve Kombetare te Kontabilitetit te permiresuara ne zbatim te ligjit 25/2018 dt. 10.05.2018 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".
  17. **Kapitali themeltar dhe Perqindjet** (te trajtuara ne piken 2 dhe 3 si me siper) e sejcilit ortak ne kapitalin themeltar per shoqerite me pergjegjesi te kufizuar te krijuara nga ndarja, do te percaktohen pas paraqitjes se raportit nga Shoqeria Audituese “Gosnishti Auditors And Partners” shpk, ne zbatim te ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare”, Neni 217,pika 1.
  18. **Caktimin e Audituesit Ligjor** Shoqerine Audituese “Gosnishti Auditors And Partners” shpk me Nipt-in L32423013P, e regjistruar ne regjistrin publik te Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar (IEKA) me Nr. 389 date 31.03.2014, me Administrator Luan Gosnishtin Auditues Ligjor, ne zbatimin te pikes 17 si me siper, per caktimin e kontributeve te dy shoqerive pritesë qe krijojen te reja, “Solid ONE Group” shpk dhe “TACI DETERGENT GROUP” shpk pas ndarjes e shoqerise “Dimex” Shpk, e cila ne fund te ketij procesi do te vleresohet e prishur (Ligji Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare”, Neni 227,pika 1) .
  19. **Bilanci i ndarjes** do te kete si baze treguesit e bilancit te vitit 2020 te shoqerise “Dimex” Shpk.(Bilanci bashkangjitur i firmosur nga te dy ortaket)
  20. **Caktimin e Ekspertit Teknik** (dhe ekspert ndertimi) Lefter Shuka me NIPT-in K31510532J dhe liçencen profesionale 0501/4 dhe VP 0292 per kryerjen e aktit te ekspertimit per te relizuar ndarjen e pasurive te paluajtshme sipas kushteve te projektmareveshjes se ndarjes ne zbatim te nenit 217 ligji Nr.9901 date 14.04.2008 “Per

- Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare” per dy shoqerite pritesse qe krijohen te reja “Solid ONE Group” shpk dhe “TACI DETERGENT GROUP” shpk pas ndarjes e shoqerise “Dimex” shpk e cila ne fund te ketij procesi do te vleresohet e prishur. (Ligji Nr.9901 date 14.04.08 “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare”, Neni 227,pika 1)
21. **Raporti teknik** per ndarjen e pasurive te paluajtshme dhe hartimi i plan rlevimeve per sejcilen shoqeri ndarese do hartohet nga Eksperti Teknik Inxh.Lefter Shuka ne zbatim te ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare”, Neni 217,pika 1.
  22. **Ndarja e pasurive te paluajtshme** do te jete ne vijim te Aktit noterial te dates 14.07.2016 duke e konsideruar ate te vlefshem.
  23. **Ndarja e pasurive te luajtshme** do te jete ne vijim te Aktit te dates 10.06.2016 duke e konsideruar ate te vlefshem.
  24. **Bilanci i ndarjes** se shoqerise “Dimex” shpk, mbi bazen e bilancit te dates 31.12.2020, ne dy shoqerite pritesse qe krijohen te reja “Solid ONE Group” shpk dhe “TACI DETERGENT GROUP” shpk do te jete pjese e pandare e kesaj projektmareveshje
  25. **Te drejtat dhe detyrimet** e shoqerise ndarese “Dimex” shpk do t’i kalojne shoqerise pritesse “TACI DETERGENT GROUP” shpk.

Per Shoqerine ndarese “Dimex” Shpk  
Perfaqesuesi Ligjor  
**Dhimiter Roko**



A handwritten signature in black ink, appearing to be "D.R.", written over a horizontal line.